

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 51135/22
Minerva KOTHERJA kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 9 shtator 2025, si një Komitet i përbërë nga:

Úna Ní Raifeartaigh, *kryetar,*

Darian Pavli,

Mateja Đurović, *gjyqtarë*

dhe Olga Chernishova, *zëvendësekretare e Seksionit,*

për sa i përket:

kërkesës (nr. 51135/22) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë, në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrotjtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa), më 18 tetor 2022, nga një shtetase shqiptare, znj. Minerva Kotherja (kërkuesja), e cila ka lindur në vitin 1951, banon në Elbasan dhe u përfaqësua nga z. E. Kotherja, avokat i cili e praktikon ligjin në Elbasan;

vendimit për të njoftuar mbi ankesën sipas nenit 6 § 1 të Konventës, në lidhje me sigurinë juridike, qeverinë shqiptare (qeveria), përfaqësuar nga z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit, dhe për të deklaruar të papranueshme pjesën tjetër të ankesës;

vërejtjet e palëve;

pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë me një mosmarrëveshje për një pronë midis kërkueses dhe palëve të tjera private. Pasi gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë e rrëzuan ankesën e kërkueses, ajo apeloj pranë Gjykatës së Lartë.

2. Më 23 qershor 2016, dhoma e këshillimit në Gjykatën e Lartë, e mbledhur me dyer të mbyllura, e shpalli apelimin e kërkueses mbi pikat e ligjit të pranueshëm dhe e referoi për gjykim.

3. Më 29 maj 2021, hyri në fuqi ligji nr. 44/2021, i cili ndryshoi Kodin e Procedurës Civile (KPC). Ndryshimet përkatëse legjislative i mundësonin Dhomës Civile në Gjykatën e Lartë, të mbledhur me dyer të mbyllura, t'i gjykonte çështjet mbështetur në merita, ndërkohë që përpara këtyre ndryshimeve këto formacione kishin kompetencë të deklaronin të papranueshme vetëm ato apeline mbi pikat e ligjit, që nuk përmbushnin kriteret e KPC-së apo ta referonin një çështje për gjykim të plotë pranë Dhomës Civile të Gjykatës së Lartë. Ndryshimet parashikonin edhe se çështjet pranë Gjykatës së Lartë, si rregull, gjykohen mbështetur në dokumentet në dosje, dhe një seancë publike mbahet vetëm për çështjet që kanë lidhje me unifikimin e praktikës gjyqësore për të dëgjuar palët për shkak të kompleksitetit të çështjes.

4. Më 7 mars 2022, Gjykata e Lartë e anuloi vendimin e saj për të gjykuar çështjen e kërkueses dhe, e mbledhur në një seancë me dyer të mbyllura, e shpalli apelimin e kërkueses të papranueshëm, në mbështetje të nenit 472 të KPC-së. Gjykata e Lartë vlerësoi pikat e ligjit të paraqitura në apelimin e kërkueses dhe konstatoi se gjykata e apelit kishte zbatuar me korrektësi si ligjin substantiv edhe atë procedural. Pjesa përkatëse e vendimit të Gjykatës së Lartë arsyeton si në vijim:

“Referuar çështjes në fjalë, Dhoma Civile [e Gjykatës së Lartë] gjykon se apeli i paraqitur nga paditësja Minerva Kotherja nuk i referohet ndonjëres prej situatave parashikuar në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile, dhe si i tillë nuk duhet të pranohet. Gjykata e Apelit ka interpretuar dhe zbatuar

me korrektësi si ligjin procedural edhe atë substantiv. Vendimi i saj nuk bie ndesh me ndonjë vendim të Dhomës Civile të Gjykatës së Lartë ose të Dhomave të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. [Gjykata e Lartë e mbledhur me dyer të mbyllura] nuk ka identifikuar ndonjë shkelje të tillë të rëndë të rregullave për procedurën, gjë që mund të bëjë të pavlefshëm vendimet [e gjykatave më të ulëta] ose procedurat [pranë këtyre gjykatave].

Gjykata e Apelit Durrës (...) i adresoi në mënyrën e duhur ankesat e bëra nga palët.

Dhoma [Civile] [e Gjykatës së Lartë] gjykon se të gjithë argumentet, në lidhje me pronësinë e tokës me sipërfaqe 156 metër katrorë, nuk kanë lidhje me këtë çështje. Zyra e Regjistrimit të Pasurive ka njohur pronësinë e pronarit të mëparshëm, paraardhësit të paditëses, dhe ky fakt nuk është kundërshtuar. Megjithatë, mosmarrëveshja në këtë çështje lidhet me pyetjen nëse trualli është [aktualisht] i zënë [nga palë të treta] ose jo, dhe nëse është i mundur rikthimi i tij, apo nëse ish-pronari ka të drejtën [vetëm] për kompensim. Gjykata e Apelit bëri të qartë se në lidhje me këto çështje ishte marrë një vendim nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive.

Në lidhje me shkaqet e ngritura në apelim, Dhoma [Civile] [e Gjykatës së Lartë] gjykon se ato kanë të bëjnë me vlerësimin e provave dhe si të tilla nuk janë në juridiksionin kushtetues të Gjykatës së Lartë.”.

VLERËSIMI I GJYKATËS

5. Mbështetur në nenin 6 § 1 të Konventës, kërkesja u ankua se ishte shkelur parimi i sigurisë juridike, sepse fillimisht Gjykata e Lartë e shpalli apelimin e saj të pranueshëm, dhe më pas e shpalli po të njëjtin apelim të papranueshëm.

6. Gjykata vëren se ankesa ngre dy çështje të ndryshme. Çështja e parë ka të bëjë me vendimin e vitit 2016 të Gjykatës së Lartë për mbajtjen e një gjykimi me dyer të hapura, përpara se ta ndryshonte atë vendim në vitin 2021 dhe të vijonte me gjykimin e çështjes me një seancë me dyer të mbyllura. Në lidhje me këtë çështje, Gjykata thekson se në përgjithësi është një parim i njohur që rregullat proceduralë të zbatohen menjëherë për procedurat që janë pezull (shih *Çela kundër Shqipërisë*, nr. 73274/17, § 27, 29 nëntor 2022, mbështetur në *Brualla Gómez de la Torre kundër Spanjës*, 19 dhjetor 1997, § 35, *Raportet të Gjykrimeve dhe vendimeve 1997-VIII*, dhe *Galeano Peñas kundër Spanjës*, nr. 48784/20, § 52, 31 maj 2022). Për këtë arsye, fakti se Gjykata e Lartë zbatoi rregullat e reja për procedurën në seancat me dyer të hapura për çështjet e mbetura pezull në vetvete nuk ishte në kundërshtim me garancitë e dhëna në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës.

7. Çështja e dytë ka të bëjë me faktin se fillimisht Gjykata e Lartë e shpalli apelimin e kërkuësës të pranueshëm dhe më pas të papranueshëm. Në lidhje me këtë çështje, Gjykata vëren se në vendimin e dytë të Gjykatës së Lartë, apelimi i kërkuësës u shpall i papranueshëm pasi gjykata shqyrtoi meritat e pretendimeve të kërkuësës për pikat e ligjit, sipas së cilit juridiksioni i saj ishte i kufizuar. Gjykata e Lartë vlerësoi se gjykatat më të ulëta kishin zbatuar me korrektësi si ligjin procedural edhe atë substantiv, dhe kishin vlerësuar plotësisht argumentet që kërkuësja kishte paraqitur në apel. Gjithashtu, ajo konfirmoi gjetjet e Gjykatës së Apelit, në lidhje me mosmarrëveshjen kryesore në çështje dhe zgjidhjen e saj (shih paragrafin 4 më sipër). Në këto rrethana, fakti se apelimi u shpall i papranueshëm paraqet vetëm një gjetje formale, ndërsa në realitet Gjykata e Lartë vlerësoi me efikasitet meritat e ankesave të kërkuësës të paraqitura përpara saj, dhe dha mjaftueshëm arsye për vendimin e saj.

8. Gjykata vlerëson se mbështetur në materialet në zotërim dhe për aq sa çështjet për të cilat janë bërë ankesat janë nën kompetencën e saj, këto ankesa nuk paraqesin ndonjë konstatim të shkeljes së të drejtave dhe lirive të parashikuara në Konventë ose në Protokollet e saj.

9. Në këto rrethana, kërkesa është qartazi e pambështetur në fakte dhe duhet të rrëzohet në mbështetje të nenit 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye Gjykata, në mënyrë unanime,

E shpall kërkesën të papranueshme.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 2 tetor 2025.

KRYETAR
Úna Ní Raifeartaigh
ZËVENDËSSEKRETARE
Olga Chernishova